



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komentet dhe përgjigjet e KPM-së lidhur me Draft Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele

Draft Rregullorja	Komentet nga AMPEK	Përgjigjet nga KPM
NENI 3 PËRKUFIZIMET 12. Licencë – leja e dhënë nga KPM-ja për shpërndarje të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele	<p>Te mbetet perkufizimi sic ka qene ne rregulloren KPM -2016/01, per faktin se aty i referohet trasnetimit dhe ritransmetimit te OSHMA-ve, terminilogji kjo e perdorur edhe ne ligjin per te drejtat e autorit dhe te drejtat e peraferta, persa i perket shperdarjes se OSHMA. Dmth perkufizimi te jete si vijon:</p> <p><u>“12. Licence- leja kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për transmetime dhe ritransmetime radio-televizive dhe shërbime mediale audio dhe audiovizuale. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së, si dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së.”</u></p>	<p>Përkufizimi në draft e ka kuptimin sipas qëllimit të kësaj Rregulloreje, e cila për objekt rregullimi ka operatorët e shpërndarjes.</p> <p>Obligimet përcaktohen me kushtet dhe termet e licencës.</p>
NENI 4 E DREJTA E SHPËRNDARJES	<p>Te shtohet paragrafi 4. 1.1 dhe te perkufizohet si ne vijim:</p>	<p>Në paragrafin 2 të nenit 4 përcaktohet afati prej 7 ditësh, ku KPM njoftohet për shtimin e OSHMA në listë.</p>

<p>1. I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale bazuar vetëm në marrëveshjet valide për shpërndarjen e tyre.</p>	<p><u>“1.1. Për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale i licencuari obligohet të sigurojë marrëveshje me shkrim nga secili ofrues i shërbimit medial apo shoqatave për administrim kolektiv. Shpërndarja e shërbimeve mediale audio-vizuale nuk duhet të fillojë para marrjes së pëlqimit nga KPM.”</u></p>	<p>Propozimi për marrje të pëlqimit/miratimit nga ana e KPM-së shkakton vonesa të panevojshme për arsye se shtimi i kanaleve nuk duhet të jetë subjekt i vendimmarrjes.</p>
<p>NENI 4 E DREJTA E SHPËRNDARJES</p> <p>3. I licencuari obligohet që për çdo ndryshim të katalogut të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, si pjesë përbërëse e Licencës, ta njoftojë KPM-në në afat prej shtatë (7) ditësh.</p>	<p>Te plotësohet neni me pjesën: “3.I licencuari obligohet që për çdo ndryshim të katalogut të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, si pjesë përbërëse e Licences, ta njoftojë KPM-ne në afat prej shtatë(7) ditësh, <u>para fillimit të shpërndarjes së ofruesve të shërbimit medial bazuar në ato ndryshime</u></p>	<p>Propozohet që tek neni 4, paragrafi 2 dhe 3, të hiqet afati për njoftim, dhe të mbetet vetëm njoftimi paraprak dhe dorëzimi i marrëveshjeve valide tek KPM-ja.</p> <p>Kjo për arsye se mund të ndodh sigurimi i ngjarjeve të caktuara nga OSH-të të njëjtën ditë kur ato ndodhin.</p>
<p>NENI 5 TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË</p> <p>4. I licencuari, gjatë shpërndarjes së ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore, obligohet të ofrojë mekanizma dhe udhëzime të qarta në mënyrë që përdoruesit do të mund të kodojnë secilin kanal që ata dëshirojnë</p>	<p>Ky nen duhet saktësisht ti referohet rregullores së KPM për mbrojtjen e të miturve, për faktin se operatorët e shpërndarjes në masë të madhe devijojnë nga kjo rregullore, dhe nuk monitorohen nga KPM përveçse për këtë çështje dhe këtë nen në veçanti. Pra të perkufizohet si vijon:</p> <p><u>4. “I licencuari, gjatë shpërndarjes së ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, duhet të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore, duke ofruar mekanizëm dhe udhëzime të qarta në mënyrë që përdoruesit do të mund të kodojnë secilin kanal që ata dëshirojnë. “</u></p>	<p>OSH-të nuk kanë qasje në politikën redaktuese të programeve të shpërndara përmes rrjetit të tyre, prandaj e vetmja mënyrë për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve është mundësia e kodimit të secilit kanal, siç parashihet në draftin e propozuar.</p>
<p>NENI 9 BARTJA E OBLIGUESHME E OSHMA- VE ME TRANSMETIM TOKËSOR</p>	<p>Te riformulohet neni si në vijim:</p>	<p>Propozohet që të shtohen obligimi i bartjes së obligueshme për të gjitha kanalet e transmetuesit publik, sidomos pas rrethanave</p>

<p>1. Të licencuarit obligohen të shpërndajnë pa kompensim dy kanalet e para televizive të transmetuesit publik (RTK1 dhe RTK2) si dhe kanalet tjera komerciale me transmetim tokësor të cilat e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme.</p>	<p><u>“2. Të licencuarit obligohen të shpërndajnë pa kompensim dy kanalet e para televizive të transmetuesit publik (RTK1 dhe RTK2).</u></p>	<p>gjatë pandemisë ku këto kanale përdoren edhe për mësimin online.</p> <p>Ndërsa propozimi i KPM-së për bartje të obligueshme për kanalet komerciale me transmetim tokësorë, përfshirë edhe ato regjionale dhe lokale, është bërë që këto kanale të jenë të qasshme për publikun meqë shfrytëzojnë një të mirë publike siç është frekuenca. Ky paragraf konsiderojmë se është i favorshëm sidomos për TV me transmetim lokal dhe regjional.</p>
<p>3. Ofruesi i shërbimit medial audiovizuel nuk mund ta refuzojë statusin e bartjes së obligueshme të përcaktuar me këtë Rregullore.</p>	<p>Propozojme që neni 9.3 të fshihet dhe të riformulohet si në vijim:</p> <p><u>3. OSHMA me transmetim tokësor, të cilat e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme të përcaktuar me këtë rregullore, kanë mundësitë vijuese:</u></p> <p><u>3.1 Periudha e negociimit prej 30 ditësh, në mes të licencuarit dhe OSHMA me transmetim tokësor fillon prej momentit kur OSHMA i listuar për bartje të obligueshme i dërgon të licencuarit kërkesë për bartje me kompensim për shfrytëzim të përmbajtjes.</u></p> <p><u>3.2 Data e pranimit të kërkesës nga i licencuari shënon fillimin e afatit 30 ditor të negociatave për kushtet kontraktuale.</u></p> <p><u>3.3 Gjatë periudhës së negociimit, i licencuari dhe OSHMA-te me transmetuesim tokësor mund të negociojnë sa i përket kushteve ekonomike mbi të</u></p>	<p>Duke pas parasysh nenin 9, paragrafi 3, është propozuar që të gjitha TV-të me transmetim tokësorë të kenë statusin e bartjes së obligueshme. Kjo për arsye që ato të përfitojnë duke u siguruar hapësirë në secilin OSH, varësisht nga zona e operimit, si dhe duke siguruar që publiku ka qasje në programet e këtyre TV-ve, pasi që të njëjtin shfrytëzojnë frekuenca si e mirë e kufizuar publike.</p> <p>Prandaj, propozimet lidhur me nenin 9.3, mbesin të diskutohen para miratimit të Rregullores.</p>

	<p><u><i>cilat permbajtja programore e OSHMA mund të shperndahet përmes rrjetit te te licenuarit.</i></u></p> <p><u><i>3.4 Nëse i licencuari dhe OSHMA nuk mund të arrijnë marrëveshje para përfundimit të periudhës për negociim:</i></u></p> <p>a) <u><i>OSHMA me transemtim tokësor mund të vendos ose të këtë statusin "e obligueshëm"ose të refuzojë bartjen.</i></u></p> <p>b) <u><i>Nëse OSHMA me transmetim tokësor zgjedh statusin "e obligueshëm" i licencuari duhet të bart OSHMA me transmetim tokësor pa asnjë ndryshim ose modifikim dhe pa kompensim.</i></u></p> <p><u><i>Nëse OSHMA me transmetim tokësor zgjedh të refuzojë bartjen, i licencuari nuk ka të drejtë të bart programin e transmetuesit tokësor.</i></u></p>	
<p>5. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale do të sigurojnë bartjen e sinjalit të tyre tek i licencuari për shpërndarje.</p>	<p>Neni 9.5 te riformulohet si ne vijim:</p> <p><u><i>"9.5 Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale do te sigurojne bartjen e sinjalit te tyre, deri tek nyja me e afert e kycjes (NODE) e të licencuarit per shperndarje.</i></u></p>	<p>KPM: Qëllimi i paragrafit është që bartja e sinjalit të sigurohet nga OSHMA-ja deri tek OSH-ja, duke mos hyrë në detaje teknike për mënyrën e bartjes, si dhe duke mos kufizuar modalitetet e bartjes, duke mos krijuar barriera/vështirësi/ kufizime në mes palëve.</p>
<p>8. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regjional e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme vetëm në operatorët e shpërndarjes që operojnë në atë komunë ose regjion respektiv.</p>	<p>Per ti ikur cfaredo keqinterpretimi qe ka ndodhur gjate gjithë ketyre viteve, propozojme qe neni 9.8 te riformulohet dhe specifikohet si ne vijim:</p> <p><u><i>"8. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regjional e gëzojne statusin e bartjes se obligueshme NE TE gjithë operatorët e shperndarjes qe operojne ne ate komune apo regjion respektiv.</i></u></p>	<p>KPM: Paragrafi i propozuar në draft si dhe komenti i dhënë kanë të njëjtin qëllim, sigurimi që të gjithë OSH-të që operojnë në zonën respektive të bartin kanalet me statusin e bartjes së obligueshme.</p> <p>Megjithatë, komenti mund të merret parasysh me qëllim të evitimit të ndonjë keqinterpretimi të mundshëm.</p>

<p>NENI 10 OBLIGIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUELE</p> <p>2. OSHMA-të, pavarësisht formës së transmetimit, duhet të ofrojnë sinjalin në baza jo-diskriminuese dhe jo-ekskluzive ndaj të gjithë operatorëve të shpërndarjes, në mënyrë që publiku të mos përjashtohet nga qasja në informim.</p>	<p>Meqenese ekskluziviteti percaktohet varesisht prej marrveshjes kontraktuale, mes te licencuarit dhe OSHMA, dhe meqenese ky nen eshte ne kundërshtim me Ligjin per Komunikime Elektronike 04/L-109, Neni 4, pika 1.24 propozojme qe ky nen te riformulohet si vijon:</p> <p><u>‘2. OSHMA-të, pavarësisht formës së transmetimit, duhet të ofrojnë sinjalin në baza jo-diskriminuese ndaj të gjithë operatorëve të shpërndarjes, në mënyrë që publiku të mos përjashtohet nga qasja në informim.’</u></p>	<p>Qëllimi i paragrafit është evitimi i monopolit në tregun medial, duke iu dhënë mundësi të gjithë OSH-ve të bartin OSHMA-në e caktuar për shkak të sigurimit të qasjes së publikut të përgjithshëm, me kushte dhe të drejta të barabarta.</p>
<p>3. OSHMA-të të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes obligohen që përcaktimet komerciale për ofrimin e sinjalit tek operatorët e shpërndarjes të jenë të favorshme, të arsyeshme dhe të bazuara mbi kushtet dhe rrethanat ekzistuese të tregut.</p>	<p>Në mënyrë që të promovohet diversitet dhe shërbim financiarisht i realizueshëm i transmetimit tokësor në Kosovë, propozojme qe edhe ky nen te riformulohet si ne vijim:</p> <p><u>“3. Te gjithe OSHMA pavaresisht formes se transmetimit, obligohen qe percaktimet komerciale per ofrimin e sinjalit tek operatorët e shperndarjes ti kene te favorshme, te arsyshme dhe te bazuara mbi kushtet dhe rrethanat ekzistuese te tregut. “</u></p>	<p>Paragrafi i referohet vetëm OSHMA-ve që nuk janë në listën e bartjes së obligueshme. Ndërsa, OSHMA-të me transmetim tokësor që janë përcaktuar të kenë statusin e bartjes së obligueshme nuk hyjnë në marrëveshje komerciale sa i përket bartjes.</p>
<p>NENI 11 LISTA E KANALEVE TË PARA</p> <p>2. Këshilli Programor i të licencuarit do të vendos për renditjen e kanaleve të tjera në katalogun e kanaleve të shpërndara nga i licencuari.</p>	<p>Per te parandaluar diskriminim bere mediave lokale e regjionale ne Kosove, propozojme qe nenit 11.2, ti shtohet edhe paragrafi si me poshte:</p> <p><u>“11.2.1.Në numeracionin logjik te kanaleve (LCN descriptor) nga 4 deri ne 30, Keshilli Programor i te licencuarit, obligohet të radhisë sinjalet e të paktën një OSHMA-je me bartje te obligueshme me mbulim regjional dhe një me mbulim lokal në zonën përkatëse të transmetimit tokësor. “</u></p>	<p>Të shtohet: Renditja e kanaleve duhet të bëhet në grupime varësisht nga natyra e përmbajtjes së kanaleve: grupi i OSHMA-ve me karakter gjeneralistik nacional, grupi i OSHMA me karakter gjeneralistik me karakter lokal/regjional, grupimet e OSHMA-ve me karakter tematike, p.sh. kanalet për fëmijë, kanalet muzikore, sportive etj.</p> <p>Renditja e grupimeve të vendoset nga Këshilli Programor i OSH-së.</p>

<p>NENI 13 NDALESAT PËR MODIFIKIM</p> <p>2. Lejohet futja e informacioneve për ngjarjet e cilësuar si: katastrofa natyrore e humanitare, kërcënim i sigurisë publike dhe përhapja e ndonjë epidemie që rrezikon shëndetin publik, nga institucionet përgjegjëse në pajtim me ligjet e aplikueshme.</p>	<p>Neni 13.2 te riformulohet si ne vijim:</p> <p><i>“2. Me miratim te KPM-se, lejohet futja e informacioneve per ngjarjete cilësuar si: katastrofa natyrore e humanitare, kërcënim i sigurisë publike dhe përhapja e ndonjë epidemie që rrezikon shëndetin publik, nga institucionet përgjegjëse në pajtim me ligjet e aplikueshme”</i></p>	<p>Në rrethana të jashtëzakonshme të përmendura në draft, kërkesa për miratim apo kërkesa tjera burokratike nga KPM-ja humb kuptimin e këtij neni, duke shkaktuar vonesa në shpërndarjen e informatave në kohë reale dhe me rëndësi për publikun e përgjithshëm.</p>
<p>NENI 15 MBROJTJA E PËRDORUESVE</p> <p>3. I licencuari obligohet të sigurojë që përdoruesi të ketë mundësinë të bëjë ri-programimin e renditjes së kanaleve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe “kontrollit prindëror” duke filluar pas kanalit informues e deri tek kanali i fundit në kuadër të pakos programore</p>	<p>Te rreshti i dyte pas fjales ‘renditjes’ te shtohet shtohet edhe fjala <i>“numerike”</i> te kanalave. Pra, propozojme qe te riformulohet si ne vijim:</p> <p>“15.3. I licencuari obligohet të sigurojë që përdoruesi të ketë mundësinë të bëjë ri-programimin e renditjes <i>numerike</i> të kanaleve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe “kontrollit prindëror” duke filluar pas kanalit informues e deri tek kanali i fundit në kuadër të pakos programore.”</p>	<p>Të merret parasysh komenti të tërësi.</p>
<p>8. I licencuari, në rastet e ndërprerjes së shërbimeve për shkaqe teknike, obligohet t’ia kompensojë përdoruesit periudhën për aq kohë sa ka pasur ndërprerje.</p>	<p>I licencuari, në rast të ndërprerjes së shërbimeve për shkaqe teknike, obligohet që me automatizëm të gjithë përdoruesve në zonën e afektuar t’ua kompensojë periudhën në minuta të mungesës së shërbimit, përmes notë kredisë apo përmes zgjatjes se afatit te skadimit te parapagimit per ate muaj, edhe nese konsumatori nuk e parashtron nje kerkesë të tillë. Bazuar ne Nenin 69 te Ligjit per Komunikime Elektronike, i licencuari eshte i obliguar qe te publikoje informacionin e përditesuar per kualitetin e shërbimeve dhe kohën e rënies(doën time) së shërbimit në secilën nyje të kyçjes së grupit të</p>	<p>Të merret parasysh komenti dhe të diskutohet dhe të përcaktohet koha minimale.</p>

	<p>konsumatorëve (NODE). Informacioni duhet te permbaje edhe harta përkatëse, ku konsumatori mund të gjejë nyjen e vet të kyçjes, dhe të informohet për periudhen e nderprejes se shërbimit që kompenzohet nga i licensuari.</p> <p>Prandaj duhet te specifikohet afati minimal nga ana e KPM-se, për të cilin obligohen operatorët e shpërndarjes që të bëjnë kompensimin.</p> <p>Konsiderojme se këto afat duhet ta përcaktoj KPM në këto rregullore.</p> <p>Andaj te shtohet një paragraf i specifikuar si në vijim: <u>“ 8.1. Për çdo nderprerje të shërbimeve për shkak të teknike, që tejkalon afatin prej 5 orësh, i licensuari obligohet që t’ia kompensojë përdoruesit .”</u></p>	
<p>NENI 3 KRITERET PËR LICENCIM</p> <p>5. Dëshmitë se pajisjet për pranimit të sinjalit mundësojnë renditjen e kanaleve sipas preferencave të përdoruesve.</p>	<p>KPM të sigurohet që këto dëshmi janë valide dhe funksionale. Ky nen dhe ky kriter ka qenë në fuqi deri tani e ka pas ngacje të shkajshme në implementim.</p>	<p>Në momentin që kandidati gjatë aplikimit për licencë ofron dëshmi se pajisjet mundësojnë teknike të përcaktuara për renditje të kanaleve, përgjegjësia bie mbi të licensuarin.</p>
Draft Rregullorja	<p>Komentet nga Operatorët Kabllor /Kujtesa/Telkos/Bledi/Fiberlink/ISP Broadcast/Max TV/Kadria NET/J@NET/Galaktika/Telecommunications/Kumona</p>	Përgjigjet nga KPM
<p>NENI 9 BARTJA E OBLIGUESHME E OSHMA-VE ME TRANSMETIM TOKËSOR</p> <p>8. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regional e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme vetëm në operatorët e</p>	<p>Konsiderojmë se ky paragraf është diskriminues për arsye se I përjashton nga bartja e obligueshme televizionet p afrekuencë toksore, madje mund të përjashtojë nga tregu sepse u jep mundësi operatorëve kabllorë që të ju kërkojnë kompensim për të futur në platformën e tyre dhe nuk I kontribuon konkurrencës së mirëfillt mediale.</p>	<p>Për tu pajisur me licencë një OSHMA-obligohet që me rastin e aplikimit të deponojë marrëveshje me operatorin e shpërndarjes duke garantuar hapësirë transmetimi së paku në një operatorë të shpërndarjes.</p> <p>Arsyeja pse janë futur televizionet me transmetim tokësorë janë në bartje të</p>

shpërndarjes që operojnë në atë komunë ose region respektiv.		obligueshme është se ato të përfitojnë duke u siguruar hapësirë në secilin OSH, varësisht nga zona e operimit, si dhe duke siguruar që publiku ka qasje në programet e këtyre TV-ve, pasi që të njëjtin shfrytëzojnë frekuenca si e mirë e kufizuar publike.
<p>NENI 10 OBLIGIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUELE</p> <p>1. OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme, mund të barten nga operatorët e shpërndarjes vetëm në bazë të marrëveshjes valide.</p>	Konsiderojmë se ky paragraf është diskriminues ndaj publikut të gjërë për arsye se i përjashtonë nga informimi dhe OSHMA-ve të liruar nga bartja e obligueshme u jep të drejtën të lidhjes së marrveshjeve selketive me operatorët e caktuar të shpërndarjes dhe nuk I kontribuon informimiit të publikut të gjërë.	Sipas Nenit 10, paragrafit 2, përcaktohet se pavarësisht formës së transmetimit OSHMA-të duhet të ofrojnë sinjalin në baza jo-diskriminuese dhe jo-ekskluzive, në mënyrë që publiku të mos përjashtohet nga qasja në informim. Përcaktimet me anë të këtij paragrafi janë vendosur në frymën e tregut të lirë ku bazë është marrëveshja valide mes palëve.
Draft Rregullorja	Komentet nga IPKO	Përgjigjet nga KPM
<p>NENI 10 OBLIGIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUELE</p> <p>3. OSHMA-të të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes obligohen që përcaktimet komerciale për ofrimin e sinjalit tek operatorët e shpërndarjes të jenë të favorshme, të arsyeshme dhe të bazuara mbi kushtet dhe rrethanat ekzistuese të tregut.</p>	<p>Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele dhe operatorët duhet të jenë të barabartë në përcaktimet komerciale, përkatësisht përcaktimi i dhënies se ofertës komerciale vetëm nga ana e OSHMA-ve do të shpie ne abuzim me pozitën e tyre duke kërkuar oferta të pafavorshme tregtare, të cilat do të ndikojnë në mos arritjen e marrëveshjeve kontraktuale me operatorët, gjë që rezulton me privimin e publikut nga e drejta për të marrë informacion të duhur dhe rrjedhimisht do te ishte në kundërshtim me parashikimin e nenit 3 par 1, 2 të Ligjit për KPM nr. 04 / L-44.</p> <p><u>Palët gjatë procesit të negociimit për përfshirjen e OSHMA-ve tek operatorët e shpërndarjes apo jo, obligohen që të bëjnë përcaktime komerciale të favorshme për të dyja palët, të arsyeshme dhe të</u></p>	Pranohet pjesërisht komenti dhe paragrafi 3 i nenit 10 do të plotësohet, duke shtuar “të dy palët”.

	<u><i>bazuara mbi kushtet dhe rrethanat ekzistuese të tregut.</i></u>	
Draft Rregullorja	Komentet nga Artmotion	Përgjigjet nga KPM
NENI 4 E DREJTA E SHPËRNDARJES 1. I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale bazuar vetëm në marrëveshjet valide për shpërndarjen e tyre.	E drejta ekskluzive duhet të përfshihet në këtë rregullore dhe të mbrohet nga KPM-ja ashtu që kësaj dispozite mendojmë se duhet ti shtohet edhe një dispozitë : <i>“Operatorët të shpërndarjes që posedojnë të drejtat ekskluzive të transmetimit të deponuara në KPM, mbrohen nga rregullatorë duke mos lejuar transmetimin nga operatorët tjerë të cilët transmetojnë në bazë të marrëveshjeve jo ekskluzive (të pa definuar).</i>	Në bazë të nenit 4.1, të gjithë të licencuarit janë të obliguar që para transmetimit të përmbajtjeve të caktuara të sigurojnë të drejtat/ marrëveshjet valide, pavarësisht nëse ato janë apo nuk janë ekskluzive. Në bazë të draftit është përcaktuar që çështja e ekskluzivitetit nuk vlen për kanalet (OSHMA) e licencuara nga KPM-ja.
NENI 5 TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË 3. Kur i licencuari gjen se një shërbim audio dhe audiovizuel ka përmbajtje ilegale, i licencuari duhet menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet.	Propozimi i caktimit të kohës 1 ore nga momenti i njoftimit nga ana e KPM-se është kohe e mjaftushme për të reaguar dhe reflektuar çdo operator i cili është duke bere shkljene e caktuar. Është mirë të caktohet sakt koha e largimit, me arsyetim se për tu verifikuar përmbajtja ilegale kerkohet kohë deri në zbardhjen e situatave. 3.Kur i licencuari gjen se një shërbim audio dhe audiovizuel ka përmbajtje ilegale, i licencuari duhet <u><i>brenda 1 ore nga momenti i njoftimit</i></u> menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet.	Lejimi apo përcaktimi i kohës për transmetimin e një përmbajtjeje pa të drejtë të transmetimit do të nënkuptonte legalizim / apo mundësi të transmetimit të një përmbajtjeje të tillë deri në një orë.
7. Ndërprerja e veprimtarisë për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj do të rezultojë me ndërprerje të licencës.	Të definohen rrethanat që e përjashtojn këtë peruidhe kohore duke patur parasyshe Forcen madhore etj. Në të kunderten masa për ndërprerje të licences duk et të jete shumë arbitrare.	Paragrafi i referohet vetëm rasteve kur nga vet i licencuari shkaktohet ndërprerja e veprimtarisë për periudhën e përcaktuar dhe e cila nuk ndikohet nga faktorët natyror. Neni 5.7 mund të plotësohet:

		Ndërprerja e veprimtarisë për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj do të rezultojë me ndërprerje të licencës, përveç rasteve kur ndërprerja është shkaktuar si rezultat i fatkeqësive natyrore.
<p>NENI 9 BARTJA E OBLIGUESHME E OSHMA-VE ME TRANSMETIM TOKËSOR</p> <p>1. Të licencuarit obligohen të shpërndajnë ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele me transmetim tokësor sipas rregullës së bartjes së obligueshme.</p>	<p>Mendojmë se ky paragraf përmban ngarkes të pa nevojshme në këtë rregullore dhe ndaj Operatorëve . Të specifikohen saktë cila kanale do të jenë në bartje të obligueshme sipas kesaj rregullore, duke vendosur edhe kriteret e matshme për këtë obligim apo të drejtë .</p> <p>Ne propozojmë që kjo ngarkes të eliminohet në tërësi nga kjo rregullore, se cila TV tokësore duhet të barten sipas parimit Bartje e Obligueshme, në rast se operatori nuk ka interes nga një TV i till, pse duhet të ketë statusin e bartjes së obligueshme në platformën tonë.</p> <p>Në cila kushte duhet të respektohet paragrafi në fjale.</p> <p>Kush i bartë shpenzimet teknike dhe teknologjike për transmetimin e kanaleve sipas bartjes së obligueshme, e të cilat kanë kosoto financiare.</p> <p>Në Republikën e Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi, tregu është i lirë dhe i garantuar, i pa kufizime , andaj ngarkimi i bartjes së obligueshme të cilat nuk janë në pajtim me parimet të bërit biznes me modelin e biznesit të orjentuar nga të licencuarit.</p>	<p>Sipas draftit është përcaktuar se të drejtën e bartjes së obligueshme e kanë vetëm OSHMA me transmetim tokësor, për shkak të qasjes së publikut në OSHMA që shfrytëzojnë brezin frekuencor si e mirë e limituar publike.</p> <p>KPM do të përcaktojë listën e OSHMA-ve me këtë status.</p> <p>Sa i përket kostos, kjo është rregulluar me nenin 9, paragrafi 2, 4 dhe 5.</p>
<p>2. Të licencuarit obligohen të shpërndajnë pa kompensim dy kanalet e para televizive të transmetuesit publik (RTK1 dhe RTK2) si dhe kanalet tjera komerciale me transmetim</p>	<p>Propozojmë që të gjitha kanalet e transmetimit të barten mbi bazën e marrëveshjes mes paleve qoftë edhe me provizion, pa u kufizuar edhe të TV kanalet publike .</p>	<p>Sipas draftit, është përcaktuar se në këtë status do të përfshihen të gjitha OSHMA-të e transmetuesit publik.</p>

<p>tokësor të cilat e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme.</p>	<p>P.sh ishte RTK 4 që oforoj mësimin online e qe ishte me interes publik një shërbim i tillë</p>	<p>Megjithatë, bazuar në këtë draft rregullore, ju lejohet që OSH-të të transmetojnë OSHMA-të tjera (që nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme) mbi bazën e një marrëveshje në mes palëve.</p>
<p>3. Ofruesi i shërbimit medial audiovizuel nuk mund ta refuzojë statusin e bartjes së obligueshme të përcaktuar me këtë Rregullore.</p>	<p>Në rastë se një OSHMA e rrefuzon statusin e bartjes se obligueshme, cilat do të jenë masat, dhe si do të vërtetoht nje situatë e tillë.</p>	<p>Sipas draftit, OSHMA e përcaktuar me statusin e bartjes së obligueshme nuk mund të refuzojnë këtë status. Në rast të kundërt, do të ndërmerren veprime ligjore sipas Ligjit të KPM-së, bazuar në nenin 19 të këtij drafti.</p>
<p>8. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele me mbulim tokësor lokal dhe regjional e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme vetëm në operatorët e shpërndarjes që operojnë në atë komunë ose regjion respektiv.</p>	<p>TV që kanë frekuenca nuk duhet te jene barrë për operatorët e shperndares, bazuar se ata e kanë një të mirë publike në shfrytëzim dhe se të njëjtit jane ne transmetim në formen e përcaktuar. Psh. Nëse kokëfundorja është e centralizuar p.sh ne Kryeqytet si ta bëjmë ndarjen për një TV qe operon ne Pejë , Prizren etj, Prandaj TV qe kanë Frekuenc nuk duhet të behen barë tek Operatorët.</p>	<p>Në bazë të draftit, është përcaktuar se OSHMA-të me transmetim tokësor do të kenë të drejtën e statusit të bartjes së obligueshme, bazuar në zonën e mbulimit, që do të thotë bartje pa pagesë në këto zona.</p> <p>Sa i përket OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional, mbetet që OSH të bart këto OSHMA në zonën e tyre të mbulimit pa kompensim, ndërsa për pjesët jashtë zonës së tyre të mbulimit, bartja e këtyre OSHMA varet nga marrëveshjet në mes palëve.</p>
<p>NENI 15 MBROJTJA E PËRDORUESVE</p> <p>3. I licencuari obligohet të sigurojë që përdoruesi të ketë mundësinë të bëjë ri-programimin e renditjes së kanaleve në pranuesin e rrjetit të cilin e posedon apo shfrytëzon, njësoj sikurse edhe të drejtën e grupimit të programeve apo edhe “kontrollit prindëror” duke filluar pas kanalit informues e deri tek kanali i fundit në kuadër të pakos programore.</p>	<p>Ky formulim duhet të ndyshohet në aspektin e funksionimit më të mire si për operatorët ashtu edhe për klientin, Andaj mendojme se mjafton të ketë mundësin për përpilimin e Listes favore, por jo që të obligohen Operatoët e shpërndarjes të fiksojne riprogramimin për secilin përdorues. Një kërkes e ketill mund të paraqes kosto shtes për operatorët dhe mendojmë se është e pa nevojshme një kërkes e tillë, duke e ditur se aktualisht në Republikën e Kosoves operojnë më shumë se 30 operatorë të shperndarjes dhe se përdoruesit mund të zgjedhin se me cilët operator mund të paguajn për ofrim të sherbimeve.</p>	<p>Në bazë të vlerësimeve në terren tek OSH, është vërtetuar që shumica e pranuesve të OSH-ve kanë mundësi teknike për rirenditje sipas preferencave të konsumatorit.</p> <p>Megjithatë, mund të përcaktohet se ky paragraf, në draft apo përmes një komentari për draftin, të vlejë vetëm për pranuesit që hyjnë në treg pas miratimit të draftit. Për pranuesit aktualisht në treg që nuk kanë këtë mundësi teknike, të mbetet që kjo të zgjidhet në mes palëve, përkatësisht dëshirës së konsumatorit nëse dëshiron ose jo të ndërrojë pranuesin.</p>

	Andaj formulimi propozojmë të jetë krijimi i listes favore të kanaleve ne vend të ri programimit të renditjes.	
Draft Rregullorja	Komentet nga KOSKABLE	Përgjigjet nga KPM
	<p>1.Pse ka ndermarr një iniciativ të tillë për ndryshimin e kësaj rregullore;</p> <p>2.Cilat janë problemet që kanë ndikuar në nevojën për ndryshimin e kësaj rregullore, kur dihet se kjo rregullore ka bërë një rregullim të shkelqysem te tregut medial;</p> <p>3.Mbi bazen e cilit kriter është bërë dallimi në mes të televizioneve me frekuence dhe pa frekuence në aspektin e rregullit te mast cary, kur dihet se të gjitha televizionet në fund të fundit I sherbejn publikut;</p> <p>4.A I ka marr parasysh KPM-ja pasojat e një ndryshimi të tillë të kësaj rregullore e cila pashmangshem do të ndikojë në mbylljen e televizioneve dhe qrrregullimin e tregut medial në Kosovë.</p>	<p>Iniciativat për ndryshim të aktit nënligjor, është ndërmarr pas kërkesave të palëve për amandamentim, për faktin se rregullorja në fuqi nuk ka lejuar raporte komerciale në mes OSH-ve dhe OSHMA (që operojnë vetëm përmes OSH-ve) me çka i është pamundësuar zhvillimi i tyre.</p> <p>Dallimi është bërë për shkak të qasjes sa më të gjerë të publikut tek OSHMA-të që shfrytëzojnë brezin frekuencor si e mirë e kufizuar e publikut, duke pas parasysh se shfrytëzimi i OSH-ve nga publiku është gjithnjë në rritje, ndërsa pranimi i sinjalit tokësor në mënyrë tradicionale (përmes antenës) është duke u zvogëluar.</p> <p>KPM ka marrë parasysh kërkesat e palëve, në këtë rast vet OSHMA-ve me transmetim përmes OSH-ve, që atyre t’u ofrohet mundësi komerciale për bartje të tyre, që edhe do të ndikojë në zhvillimin e tyre.</p>
<p>NENI 9 BARTJA E OBLIGUESHME E OSHMA-VE ME TRANSMETIM TOKËSOR</p> <p>NENI 10 OBLIGIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUELE</p>	<p>Po ashtu veq tjerash ndryshimim i statusit të bartjes së obligueshme do ti largon nga tregu edhe shum televizione pa frekuencë, pasi që do të lihet mundësia që operatorët kabllorë tju kerkojnë kompezim per ti futur në platformë, e krejt kjo qe u tha më lart ndikon negadivisht në shprehjen e lir si dhe ne konkurrencen mediale te mirëfillt.</p> <p>Andaj Shoqata Koscable si përfaqshues I anetareve të saj, e kundërshton fuqishem ndryshimin e nenit 10 te</p>	<p>Siç u theksua më lartë, drafti ka përcaktuar se vetëm OSHMA-të me transmetim tokësor do të jenë me statusin e bartjes së obligueshme.</p> <p>OSHMA-të që transmetojnë përmes OSH-ve u mundësohet që bartja e tyre të bëhet sipas marrëveshjeve me OSH-të, duke u krijuar mundësi komerciale mes tyre. Po ashtu, gjatë aplikimit për licencë, këto OSHMA janë të</p>

	rregullores se 2016 e që në draft rregulloren e re e keni modifikuar në nenin 9 dhe 10.	obliguar që të sigurojnë hapësirë paraprakisht tek OSH-të.
Draft Rregullorja	Komentet nga KLAN KOSOVA	Përgjigjet nga KPM
	Shprehet se mbështet në tërësi draftin e Rregullores	
Draft Rregullorja	Komentet nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës AGK	Përgjigjet nga KPM
	Mbështet komentet e Asociacionit të Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës AMPEK	Komentet janë sqaruar më lartë
Draft Rregullorja	Komentet nga TV MITROVICA	Përgjigjet nga KPM
	<p>Kërkesa nr.1.</p> <p>Kërkojmë që rregullorja të detyrojë operatorët kabllorë që përmbajtjet televizive t'i ndajë me blloqe.</p> <p>Në bllokun e parë të jenë televizionet me përmbajtje të përgjithshme informative.</p> <p>Blloku 2. Televizionet me përmbajtje programesh për fëmijë</p> <p>Blloku 3. Televizionet me përmbajtje programesh dokumentare</p> <p>Blloku 4. Televizionet me përmbajtje programesh sportive</p> <p>Blloku 5. Televizionet me përmbajtje programesh muzikore</p> <p>Blloku 6. Televizionet me përmbajtje programesh filma zhanresh te ndryshme.</p>	<p>Duke marrë për bazë komentin e dhënë nga AMPEK, është propozuar që kjo çështje të rregullohet si në vijim:</p> <p>Renditja e kanaleve duhet të bëhet në grupime varësisht nga natyra e përmbajtjes së kanaleve: grupi i OSHMA-ve me karakter gjeneralistik nacional, grupi i OSHMA me karakter gjeneralistik me karakter lokal/regjional, grupimet e OSHMA-ve me karakter tematike, psh. Kanalet për fëmijë, kanalet muzikore, sportive etj.</p> <p>Renditja e grupimeve vendoset nga Këshilli Programor i OSH-së.</p>

	<p>Blloku 1 të ndahet në 3 nënbloqe, ku nënblloku i parë do të jetë ai televizioneve vendore (must carry) duke filluar me RTK1 e RTK2, nënblloku i dytë me televizionet e vendeve fqinjë dhe nënblloku i tretë me televizionet ndërkombëtare (keto 2 te fundit nese rrjeti kabllor deshiron t'i kete).</p>	
	<p>Për transmetimin e televizioneve jo të licensuara në Kosovë, taksën e operimit (e cila duhet të jetë e pak më e lartë se ajo që paguajne OSHP-të vendore) e paguan operatori kabllor për secilin TV të huaj që e futë në rrjetin e vet dhe njëkohësisht operatori kabllor përgjigjet për përmbajtjet e këtyre televizioneve kur ato përmbajtje nuk janë në harmoni me ligjet e Kosovës.</p> <p>Fondet e përfituara nga kjo taksë të përdorën nga KPM për të financuar programet edukative, programet për fëmijë, programet ekologjike dhe për programet që kultivojnë patriotizmin modern.</p> <p>TV MITROVICA TV PRIZRENI TV TEMA TV LIRIA TV VALI TV OPINION TV BESA TV ILIRIA TV 1'st Channel</p>	<p>Obligimi i OSH-ve është pagesa e taksës vjetore për veprimtarinë që ushtrojnë, ndërsa kanalet e huaja si pjesë e përmbajtjes së OSH-ve rregullohen / sigurohen përmes marrëveshjeve për të drejtën e autorit.</p> <p>Ndërsa, sipas draftit OSH-të janë përgjegjëse për çdo përmbajtje që ofrojnë sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në nenin 5.3 dhe 19.2 të këtij drafti.</p>
Draft Rregullorja	Komentet nga Oda Ekonomike e Kosovës	Përgjigjet nga KPM

	Ka kërkuar të miratohet ky draft <i>“ne menyre qe te perkrahet tregu i lire, dhe te ju ofrohet nje ambient i pershtatshem te gjitha paleve per te ushtruar veprimtarite e tyre ekonomike dhe informative, njekohesisht duke mos cenuar ne asnje moment informimin publik nga ofruesit nacional.”</i>	Në bazë të draftit të propozuar kjo mundësohet për të gjitha OSHMA-të, përveç atyre me transmetim tokësor, për shkak të sigurimit të qasjes së publikut në OSHMA që shfrytëzojnë të mirat e kufizuara publike (frekuencat).
Draft Rregullorja	Komentet nga Oda Ekonomike Amerikane	Përgjigjet nga KPM
	Mundësimi i vendosjes së marrëdhënieve komerciale ndërmjet kanaleve televizive dhe operatorëve kabllorë, duke vlerësuar se shtimi i një dispozite të tillë është më se i nevojshëm për të mundësuar trajtim të barabartë në mes të mediave televizive që operojnë në Kosovë në relacion me operatorët kabllorë, derisa e njëjta është gjithashtu në përputhje me praktikat që aplikohen në shtetet e Bashkimit Evropian.	Në bazë të draftit të propozuar kjo mundësohet për të gjitha OSHMA-të, përveç atyre me transmetim tokësor, për shkak të sigurimit të qasjes së publikut në OSHMA që shfrytëzojnë të mirat e kufizuara publike (frekuencat).
Draft Rregullorja	Komentet nga TvMost, Tv Herc, TV Puls, Tv Kim, Tv Kiss, TvMir, TvZoom	Përgjigjet nga KPM
	Ndryshimi i statusit Must Carry si televizion na përjashton neve nga platformat kabllore në Kosovë dhe gjithashtu i fuqizon operatorët kabllor që janë politikisht të influencuar për të mbyllur një dritare informative të popullatës sonë.	Në bazë të draftit të propozuar, të gjitha OSHMA-të me transmetim tokësor do të kenë statusin e bartjes së obligueshme për shkak të sigurimit të qasjes së publikut në OSHMA që shfrytëzojnë të mirat e kufizuara publike (frekuencat). Në këtë rast, përveç TV KISS dhe TV KIM, OSHMA-të tjera do të gëzojnë këtë status. Për OSHMA-të që operojnë përmes OSH-ve sigurimi i hapësirës bëhet gjatë aplikimit për licencë, pas një marrëveshje paraprake me OSH-të, e cila është edhe e paraparë me nenin 15.2 të Rregullores 2017/02.